

Në bazë të nenit 24, paragrafi (1), pika 1), nënpika 21 dhe nenit 191 paragrafi (10) të Ligjit të Energjetikës* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19) dhe nenit 16 të Rregullores së Prodhuesve Preferencial, që Përdorin Tarifë Preferenciale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 116/19), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 19 nëntor 2020, miratoi

AKTVENDIM TË MARRJES SË STATUSIT TË PRODHUESIT PREFERENCIAL

1. Shoqërisë së Prodhimit, të Tregtisë dhe të Shërbimeve HCEV TOPOLKI SHPK Shkup, i jepet Aktvendim i Marrjes së Statusit të Prodhuesit Preferencial për hidrocentralin elektrik HCEV "Topolka me nr. ref. 315".
2. Të dhëna për bartësin e aktvendimit:
 - emri i selisë: Shoqëria e Prodhimit, e Tregtisë dhe e Shërbimeve HCEV TOPOLKI SHPK Shkup, me seli në bul. "Shën Klimenti i Ohrit" nr. 30, Shkup - Qendër.
3. Të dhënat për centralin elektrik:
 - numri unik i regjistrimit të centralit elektrik: PP-SH-209;
 - emri e centralit elektrik: hidrocentrali elektrik HCV "Topolka me nr. ref. 315",
 - Të dhënat për lokacionin e centralit elektrik: në PK nr.1169/8 KK Jabollçishtë e Poshtme dhe PK nr.359/4 KK Drenovë, komuna e Çashkës,
 - fuqia e instaluar e centralit elektrik: 2.160 kW (një njësi gjeneruese me fuqi prej 2.160 kW) dhe
 - prodhimi i planifikuar vjetor i energjisë elektrike nga centrali elektrik: 5.356.380 kWh.
4. Ky aktvendim nuk do të vlejë më nga data 26 nëntor 2040.
5. Ky aktvendim të dërgohet deri te parashtuesi, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Energjetikës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
6. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e shtatë të miratimit të tij, ndërkaq botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

A R S Y E T I M

Shoqëria e Prodhimit, e Tregtisë dhe e Shërbimeve HCEV TOPOLKI SHPK Shkup, me seli në bul. "Shën Klimenti i Ohrit" nr. 30, Shkup - Qendër, në përputhje me Rregulloren e Prodhuesve Preferencial, që Përdorin Tarifë Preferenciale (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), më 5 nëntor 2020, deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Rregullator i Energjetikës) parashtroi kërkesë për miratimin e Aktvendimit të Marrjes së Statusit të Prodhuesit Preferencial të Regjistruar nën numrin e arkivit PA1 nr. 08-180/20 dhe Kërkesë të Përdorimit të Tarifës Preferenciale të Energjisë Elektrike të regjistruar nën numër arkivi PA1 nr. 08-181/20, për hidrocentralin elektrik HCEV „Topolka me nr. ref. 315”, me fuqi të instaluar prej 2.160 kW dhe me lokacion në PK nr. 1169/8 KK Jabollçishtë e Poshtme dhe PK nr. 359/4 KK Drenovë, komuna e Çashkës.

Shoqëria e Prodhimit, e Tregtisë dhe e Shërbimeve HCEV TOPOLKI SHPK Shkup është bartëse e Aktvendimit të Marrjes së Statusit të Prodhuesit Preferencial të Regjistruar të Prodhuar nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë për hidrocentralin elektrik HCEV "TOPOLKA me nr. ref. 315" me fuqi të planifikuar prej 2.133 kW dhe me lokacion nr. ref. 315 në rrjedhën e ujit të lumit Topolka, KK Jabollçishtë e Poshtme dhe KK Drenovë, komuna e Çashkës, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë"

nr.182/15 dhe 85/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.233/19) të lëshuar nga Komisioni Rregullator i Energjetikës.

Në bazë të nenit 191, paragrafi (9) të Ligjit të Energjetikës* dhe nenit 13 paragrafi (1) të Rregullores, Komisioni Rregullator i Energjetikës më 11 nëntor 2020 kërkoi që Agjencia e Energjetikës e Republikës së Maqedonisë së Veriut të lëshojë vërtetim për hidrocentralin elektrik HCEV "Topolka me nr. ref. 315" Shoqëria e Prodhimit, e Tregtisë dhe e Shërbimeve HCEV TOPOLKI SHPK Shkup.

Më 12 nëntor 2020, Agjencia e Energjetikës e Republikës së Maqedonisë së Veriut lëshoi Vërtetim nr. 03-646/2, se hidrocentrali elektrik HCEV „Topolka me nr. ref. 315” i Shoqërisë së Prodhimit, të Tregtisë dhe të Shërbimeve HCEV TOPOLKI SHPK Shkup është ndërtuar dhe i plotëson kushtet e veçanta dhe fuqinë e instaluar të përcaktuara me Dekretin e Tarifave Preferenciale të Energjisë Elektrike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 56/13).

Nga dokumentacioni i dërguar nga Shoqëria e Prodhimit, e Tregtisë dhe e Shërbimeve HCEV TOPOLKI SHPK Shkup, është përcaktuar se kërkesa për miratimin e Aktvendimit të Marrjes së Statusit të Prodhuesit Preferencial të regjistruar nën numrin e arkivit PA1 nr. 08-180/20 dhe Kërkesa e Përdorimit të Tarifës Preferenciale të Energjisë Elektrike të regjistruar nën numër arkivi PA1 nr. 08-181/20, për hidrocentralin elektrik HCEV "Topolka me nr. ref. 315", me fuqi të instaluar prej 2.160 kW dhe me lokacion në PK nr.1169/8 KK Jabollçishtë e Poshtme dhe PK nr. 359/4 KK Drenovë, komuna e Çashkës, janë të plota dhe nuk kanë mangësi dhe vërtetimi i lëshuar nga Agjencia e Energjetikës e Republikës së Maqedonisë së Veriut është pozitive, me çka Komisioni Rregullator i Energjetikës, më 19 nëntor 2020 mbajti seancë, në të cilën miratoi Aktvendimin e Marrjes së Statusit të Prodhuesit Preferencial dhe Vendimin e Përdorimit të Tarifës Preferenciale të Energjisë Elektrike për hidrocentralin elektrik HCEV "Topolka me nr. ref. 315", me fuqi të instaluar prej 2.160 kW dhe me lokacion në PK nr. 1169/8 KK Jabollçishtë e Poshtme dhe PK nr. 359/4 KK Drenovë, komuna e Çashkës, të Shoqërisë së Prodhimit, të Tregtisë dhe të Shërbimeve HEV TOPOLKI SHPK Shkup.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të inicohet kontest administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes.

PA1, nr. 08-180/20

19 nëntor 2020

Shkup

**Kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës
dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së
Maqedonisë së Veriut**

Марко Бислимоски